

Nëse dëshironi të na kontaktoni ne:

Independent Review Service

4th Floor, Centre City Podium
5 Hill Street
Birmingham. B5 4UB

Phone: 0800 096 1926
Textphone: 0800 096 1929
Fax: 0121 606 2180
eMail: em@irs-review.org.uk
Website: www.irs-review.org.uk

Udhëzues bazë për Fondin Social

Informacione të tjera dhe statistika rreth rishqyrtimit të inspektorëve të fondit social në Irlandën e Veriut janë të vlefshme prej:

Office of the Social Fund Commissioner. Scottish Amicable Building, 11 Donegal Square South, Belfast. BT1 5JE

Freephone: 0808 127 0417 Fax: 0280 9023 0921 eMail: sfc@osfnci.org.uk Website: www.osfnci.org.uk

Rishikim i pavarur i Shërbimit
per fondin social



INVESTOR IN PEOPLE

irs

Independent Review Service
for the Social Fund

Hyrje

Ky tregues është një përmbledhje bazë e Fondit Social.

Skemat e Fondit Social ofron dhënie parash (grant) dhe hua bankare pa interes që të ndihmojë personat me të ardhura të ulëta, shpenzimet e të cilave janë vështirë për tu përballuar prej të ardhurave të zakonshme.

Rishikimi i pamvarur i Shërbimit (IRS) është një trup i parashikuar me statut me qëndër në Birmingham. Roli i tij është që të kryejë rishqyrtime të pamvarura të nevojave për Fondin Social. Inspektori i Fondit Social i cili kryen rishqyrtimin e pamvarur do të marri vendimin bazuar në të gjitha rrethanat e çështjes (lëndës).

IRS-ja:

- Ndryshon mbi gjysmën e vendimeve të Fondit Social që rishqyrtojmë.
- Merr një vendim në çështjet e përditshme të Fondit Social brenda 12 ditëve.
- Merret me huatë urgjente brenda 24 orëve ose më pak.

Llojet e pagesave dhe format e aplikimit

Janë tre lloje pagesash dhe tre lloje formash aplikimi:

- Dhënie parash prej Kujdesit Komunitar SF300
- Hua Krize SF401
- Hua parash buxhetore SF500

Plotësimi i formave të aplikimit

Klientat kanë nevojë që të këshillohen që të vendosin sa më shumë informacion përkatës në formën e aplikimit që të jetë e mundur. Është thelbësore që të përfshihen:

- Detaje rreth nevojës dhe si dilet (zgjidhet) prej saj.
- Rrethanat e tyre personale.
- Si mungesa e artikullit (sendit) të kërkuar ka efekt në to.

Dhënie parash nga Kujdesi Komunitar

Përshtatshmëria

Dhënie parave nga Kujdesi Komunitar mund tu paguhet personave të cilët marrin një nga këto; asistence sociale (income support) ose asistencë papunësie (income-based jobseeker's allowance) ose pension shteti.

Kualifikimi

Në terminologji ne gjerësi, një klient mund të kualifikohet për hua parash nëse:

- Ai apo pjesëtar i familjes jeton nën kujdes dhe ka nevojë që të vendosi veten e tij në komunitet.
- Ai apo pjesëtar i familjes ka nevojë për ndihmë që të qëndroje në shtëpinë e tij, më mirë sesa të shkojë në një formë strehimi ku kujdesi do ti ofrohet.
- Familja është duke u ballafaquar me presion të jashtëzakonshëm
- Ai ka nevojë të ndihmojë të kujdeset për një të burgosur ose një të ligjshkelës në lirim kalimtar prej burgut.
- Ai është duke përgatitur shtëpi si pjesë e planifikuar e programit të rimarrëveshjes pas qënies i parregulluar me jetën.
- Ai dhe familja e tij kanë nevojë për shpenzimet e udhëtimeve për një arësye specifike.

Huatë e krizave

Janë dy lloje huaje krizash:

- Hua krize për shpenzimet e jetesës.
- Hua krize për sende (artikuj).

Përshtatshmëria

Klienti nuk duhet të jetë në marrje të ndonjë benefici (ndihmave), por duhet të jetë pa burime të mjaftueshme të nevojave për të cilat ato kanë aplikuar.

Kualifikimi

Të kualifikohesh për hua krize klienti apo pjesëtar i familjes së tij duhet të përballojë shpenzimet:

- Në rast urgjent ose si rezultat i ndonjë fatkeqësie.
- Dhe dhënia duhet të bëhet vetëm në mënyrë që të parandalojë dëmtimin serioz ose rrezik serioz për shëndetin.

Dhënia e Huasë Buxhetore

Huaja Buxhetore mund të paguhet që të ndihmojë klientat të blejnë apo të paguajnë për disa kategori nevojash:


Blerje:

- Mobilje dhe pajisje shtëpiake ose
- Veshmbajthje dhe këpucë

Paguan për:

- Shpenzimet e udhëtimit
- Qera shtëpie në avancë dhe/ose shpenzimet e lëvizjes që të ndihmojë lëvizjen në shtëpinë e re
- Përmirësim, mirëmbajtje dhe sigurimi i shtëpisë
- Shpenzimet nëse klienti është duke kërkuar për tu kthyer në punë
- Debite dhe ripagesat e blerjeve me qera.

Procesi i Fondit Social



Rishqyrtimi i Kërkesës

Të dyja kërkesat e rishqyrtimit duhet të:

- Bëhen me shkrim.
- Dërgohet tek zyra e Jobcentre Plus përkatëse.
- Përmban në hollësi bazat specifike në të cilat aplikimi për rishqyrtim është bërë.
- Firmosur prej personit i cili bën këtë aplikim dhe ka autorizuar nëse ka përfaqësues ligjorë.
- I bërë brenda 28 ditëve nga data e lëshimit të vendimit, por aplikimet e vona mund të pranohen.

IRS bashkëpunon me klientin

Inspektori i cili merret me lëndën tuaj do të dërgojë tek klienti:

- Një dosje të thjeshtë të dokumentave të rëndësishëm të lëndës
- Një letër nisur prej inspektorit:
 - faktet përkatëse të lëndës
 - detajet e çështjeve vendimtare që do të caktohen
 - dhe çdo pyetje që inspektori ka nevojë të pyesë.

Mundësitë e inspektorit

- Konfirmimin e vendimit
- Drejtojë lëndën për një vendim të ri.
- Zëvendësojë vendimin me vendimin e tij.

Si mund të kontaktoni IRS-në



The Business Team

Independent Review Service
4th Floor,
Centre City Podium,
5 Hill Street,
Birmingham. B5 4UB



Ju mund të telefononi ne ne: **0121 606 2160** ose dërgo faks në **0121 606 2191**



Ju mund të vizitoni faqen e internetit (website) tek:
www.irs-review.org.uk or e-mail us at **em@irs-review.org.uk**